

REPubLIKA E SHQIPERISE
Shoqeria "ORPC-ALBANIA" Sh.p.k
Selia : Tirane.
NIPT L12227020K.

VENDIM Nr. 1 , date 24-04- 2015
i Asamblese se Jashtezakoneshme , te Ortakeve te Shoqerise
"ORPC-ALBANIA " sh.p.k.

Ne Tirane, sot me daten 24-04- 2015 (dymije e pesembedhjete), ne seline e shoqerise, u mbledh Asambleja e Jashtezakoneshme, e ortakeve te shoqerise "ORPC-ALBANIA" sh.p.k, me ortaket e shoqerise :

- 1.Ortaku Fran Radaçi 50 % Pjesemarrje ne perqindje.
- 2.Ortaku Kozeta Qehajaj 50 % Pjesemarrje ne perqindje .

Shoqeria "ORPC-ALBANIA" sh.p.k, eshte krijuar person juridik. Shoqeria ka NIPT L 12227020K. Administrator z. Fran Radaci.
Ortaket e shoqerise, bashkerisht vendosen:

VENDIM :


Dhurimin e kuotave nga Ortaku Kozeta Qehajaj, tek Ortaku Fran Radaçi dhe largimin si ortak nga shoqeria.

Me kete dhurim, shoqeria "ORPC-ALBANIA" sh.p.k, do te kete Ortakun e Vetem Fran Radaçi, Pjesemarrja ne perqindje 100 % .

Vendimi i mesiperm, merret nga ortaket, bazuar ne nenet perkatese te Statutit te shoqerise, si dhe bazuar ne Ligjin Nr. 9901, date 14/04/2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", Ligjin Nr. 9723, date 03/05/2007, "Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit ". Vendimi i ortakeve firmoset nga ortaket prezent, me vullnet te lire e te plote sipas ligjit.

Ortaket e Shoqerise

Kozeta Qehajaj


Fran Radaçi

ORPC - ALBANIA
SHPK Import - Export
TIRANE - ALBANIA



KONTRATË - DHURIM - KUOTASH
në shoqëri të "ORPC-ALBANIA" Sh.p.k.

Në Tiranë, sot më datë 24/04/.....2015 (dymijë e pesëmbëdhjetë), përpara meje **Mimoza A. Papa**, Noter, me seli në rrugën "Reshit Çollaku", Ndërtesa Nr.24, kati dytë, zyra Nr. 1, Pallati pranë Albtelekomit, u paraqiten të personalisht palet, të cilët hartojnë kontratën e dhurimit. Me poshtë do të quhen 'Dhurues' dhe 'Pranues të Dhurimit'.

PALËT PJESMARËS NË KONTRATË

DHURUES :

Znj.KOZETA QEHAJAJ, shtetase Shqiptare, e bija e Benardin, e datëlindjes 08-08-1979, lindur në Mat, banuese në Tiranë, rruga "Komuna e Parisit", madhore me zotësi të plote për të vepruar, e identifikuar me Letërnjoftim, numer personal H95808065L, më poshtë do të quhet 'Dhuruesi'.

PRANUES I DHURIMIT :

Z.FRAN RADAÇI, shtetas Shqiptar, i biri Preng, i datëlindjes 21-10-1966, lindur në Perlat, Qender Mirdite, banues në Tiranë, rruga "Dhimiter Kamarda", banesa Nr.72, madhor me zotësi të plote për të vepruar, i identifikuar me Letërnjoftim, numer personal G61021089V, më poshtë do të quhet 'Pranues i Dhurimit'.

Une Noteri, pasi u binda për identitetin e paleve dhe aftësinë e tyre për të vepruar, hartova këtë kontratë që lidhet me dhurimin dhe pranimin e kuotave, në shoqëri, me kushtet e kërkuara prej tyre, si më poshtë vijon :

NENI 1.

Numeri i Pjeseve, Pjesmarrja në përqindje e Pales Dhuruese, në Kapitalin e shoqërisë: Dhuruesi është Ortak i shoqërisë, Vlera e kapitalit 5.000,00 Leke, Numeri i pjeseve 50,00, Pjesmarrja në përqindje 50 %.

NENI 2.

Miratimi i dhurimit

Shoqëria "ORPC-ALBANIA" sh.p.k, ka bërë Mbledhjen e Asamblese së Jashtëzakonshme të Ortakëve të shoqërisë. Në mbledhje Ortaket e shoqërisë, Ortaku Kozeta Qehajaj ka vendosur të dhurojë, tek Ortaku tjetër Fran Radaçi, të gjithë kuotat e tij, Numeri i pjeseve 50,00, Pjesmarrja në përqindje 50%, Vlera e Kapitalit 50.000 Leke dhe të largohet nga shoqëria si Ortak.

Kozeta Qehajaj
[Signature]



Fran Radaçi
[Signature]

Ky dhurim bëhet në përputhje me vullnetin e lire, të plote, të ortakut të shoqërisë, bazuar në ligjin tregëtar dhe Statutin e Shoqërisë.

NENI 3.

(Koment për pasurinë): Shoqëria "ORPC-ALBANIA" sh.p.k, është krijuar person juridik date 27-10-2011. Kapitali 10.000,00 Leke, Numeri i Përgjithshëm i kuotave 100,00, Ortakë të shoqërisë Fran Radaçi, Pjesmarrja në përqindje 50%, Kozeta Qehajaj përqindja e pjesmarrjes 50 %. Sipas Ekstraktit, Historiku i Regjistrimit Tregëtar, leshuar date 24-04-2015, nga QKR.

NENI 4.

OBJEKTI

Objekt i kontratës është dhurimi dhe pranimi i dhurimit, të kuotave nga Ortaku i shoqërisë znj. Kozeta Qehajaj, tek Ortaku tjetër z.Fran Radaçi. Me këtë dhurim z.Fran Radaçi behet Ortaku i Vetëm i shoqërisë me Pjesmarrje në Përqindje 100 %, në kapitalin e shoqërisë.

NENI 5.

DHURIMI I KUOTAVE :

Dhurimi i kuotave, behet në shperblim, me vullnet të lire, të plote, mbasi behet me marrëveshje dhe mirekuptimi ndërmjet tyre. Me këtë dhurim z.Fran Radaçi, behet Ortak i Vetëm, Pjesmarrje në përqindje 100 %, në kapitalin e shoqërisë.

Znj. Kozeta Qehajaj largohet si ortak nga shoqëria "ORPC-ALBANIA" sh.p.k.

NENI 6.

DETYRIMET E PALËVE

A. Detyrimet e Dhuruesit

a/1/ Dhuruesi, ditën e nënshkrimit të kësaj kontrate, largohet nga shoqëria, si Ortak.
a/2. Dhuruesi garanton pranuesin e dhurimit, për rregullsinë e të gjithë dokumentacionit bashkëngjitur kësaj kontrate. Me këtë dhurim, dhuruesi nuk ka më asnjë pretendim, të drejtë, në shoqërinë "ORPC-ALBANIA" sh.p.k.

B- Detyrimet e Pranuesit të Dhurimit :

b/1 Pranuesi i Dhurimit, merr përsipër, të bëjë depozitim të kësaj kontrate, pranë QKR për të bërë veprimet përkatëse.
b/2 Pranuesi i Dhurimit, merr përsipër të gjithë të drejtat e detyrimit e shoqërisë, nga momenti i nënshkrimit të kontratës.

NENI 7

Mosmarrëveshjet

Mosmarrëveshjet që lindin nga kjo kontratë, do të zgjidhen me mirekuptim nga palet duke u nisur nga marrëdhëniet e mirkuptimit ndërmjet tyre, si dhe në zbatim të vete Ligjit tregëtar.

Kozeta Qehajaj
[Signature]



Fran Radaçi
[Signature]

NENI 8.

Hyrja në fuqi.

Kjo kontratë hyn në fuqi menjëherë nga data e nënshkrimit.

NENI 9

Te Ndryshme

Une Noteri, pasi u'a lexova me ze të lartë paleve këtë Kontratë, palet me deklarojnë se e kuptojnë, janë dakort dhe nënshkruajnë përpara meje me vullnet të lire, të plote sipas Ligjit. Une Noteri e vertetoj këtë fakt, sipas ligjit. Kontratë hartohet në katër kopje origjinale. Një kopje depozitohet në zyren e Noterisë, të tjerat u jepën paleve.

Baza ligjore: Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, Ligji Nr.9901, date 14/04/2008 "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare", Ligji Nr. 9723, date 03/05/2007, "Për Qendren Kombëtare të Regjistrimit". Ligji Nr. 7829, date 01-06-1994, 'Për Noterine', i ndryshuar.

DHURUES

Kozeta Qehajaj
[Signature]

Fran Radaçi
[Signature]

NOTER

Mimoza A. Papa
[Signature]





KONTRATË DHURIMI KUOTASH
TË SHOQËRISË "ORPC-ALBANIA" Sh.P.K.

Sot, në Tiranë, më datë 10.06.2015 (dymijë e pesëmbëdhjetë), përpara meje Julian Zhelegu, Noter pranë Dhomës së Noterëve Tiranë, u paraqitën personalisht palët e mëposhtme, të cilat më kërkuan redaktimin e kësaj Kontrate Dhurimi Kuotash.

Z. Fran Radaçi, shtetas shqiptar, lindur me 21/10/1966 ne Perlat Qender, Mirdite, banues ne Tiranë, mbajtës i kartes se identitetit me Nr.024393878 dhe Nr. Personal G61021089V, madhor e me zotesi te plote juridike e per te vepruar;

(në vijim e për efekt të kësaj Kontrate referuar si "Dhuruesi");

dhe

Z. Marian Radaçi, shtetas shqiptar, lindur në Perlat, Mirdite më 12.04.1977 dhe banues në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit Nr. 029283184 dhe nr. personal H70412078P, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar;

(në vijim e për efekt të kësaj Kontrate referuar si "Pranuesi");

Në vijim e për efekt të kësaj Kontrate, Dhuruesi dhe Pranuesi do të referohen veçmas si Palë/a dhe së bashku si Palë/t.

MEQENËSE:

- Shoqëria "ORPC-ALBANIA" Sh.p.k, është një shoqëri ekzistuese sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, e regjistruar ne Regjistrin Tregtar Shqiptar me NIPT L12227020K, me seli ne adresen: Tirane, Kashar, Yrshek, Autostrada Tirane - Durres,Kilometri 6, Yrshek, Tiranë, me nje kapital prej 10.000.00 lek, i perbere nga 100 kuota;
- Siç rezulton nga ekstrakti i regjistrit tregtar lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit për të dhënat e Shoqërisë, Dhuruesi zotëron 67 (gjashtedhjetë e shtate) kuota, që përfaqësojnë 67 % (gjashtedhjetë e shtate përqind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë;
- Dhuruesi i ka njoftuar Pranuesit dëshirën e tij për dhurimin e 33 (tridhjetë e tre) kuotave, që përfaqësojnë 33 % (tridhjetë e tre përqind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë dhe Pranuesi ka pranuar të fitojë kuotat e zotëruara nga Dhuruesi në Shoqëri sipas parashikimeve te kesaj Kontrate;



Në zbatim të kërkesave të Statutit të Shoqërisë dhe pasi transferimi i kuotave sipas kësaj Kontrate është miratuar sipas Vendimit bashkëlidhur te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve te Shoqerise, Palët kanë vendosur të lidhin këtë Kontratë;

ATËHERË, duke qenë se ekzistojnë këto kushte paraprake, për të cilat Palët nuk kanë pretendime apo kundërshtime, Palët bien dakord për sa më poshtë vijon:

Neni 1 Objekti

- Dhuruesi i dhuron dhe Pranuesi pranon të fitojë pronësinë për gjithsej 33 (tridhjetë e tre) kuota, që përfaqësojnë 33 % (tridhjetë e tre përqind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë "ORPC-ALBANIA" Sh.P.K.
- Kuotat si më sipër janë të lira nga ndonjë barrë dhe të garantuara plotësisht sipas kushteve të kësaj Kontrate.

Neni 2 Deklarimet dhe garancite

2.1. Dhuruesi pranon se deklarimet e mëposhtme janë të vërteta, të plota dhe nuk përmbajnë keqinformime në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate:

- Dhuruesi ligjërisht e në momentin e nënshkrimit zotëron kuotat që do të transferohen sipas kësaj Kontrate, dhe ka të drejtën për t'i transferuar këto kuota.
- Nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga Dhuruesi nuk vjen në kundërshtim me ligjet, Statutin, kontratat, marrëveshjet apo dokumente të tjera ligjore, subjekti i të cilave është Dhuruesi.
- Çdo deklarim apo garanci e dhënë nga Dhuruesi sipas kësaj Kontrate nuk përmban gabime materiale apo ometime.

2.2. Pranuesi pranon se deklarimet e mëposhtme janë të vërteta, të plota dhe nuk përmbajnë keqinformime në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate:

- Pranuesi ka tagra të plota për të pranuar kuotat nga Dhuruesi sipas përcaktimeve të kësaj Kontrate.
- Nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga Pranuesi nuk vjen në kundërshtim me ligjet, Statutin, kontratat, marreveshjet apo dokumente të tjera ligjore, subjekti i të cilave është Pranuesi.

Neni 3 Transferimi i të drejtave mbi kuotat

3.1. Pronësia mbi kuotat e Shoqërisë, objekt i kësaj Kontrate, kalon nga Dhuruesi te Pranuesi menjëherë me nënshkrimin e kësaj Kontrate. Kalimi i pronësisë së kuotave të Shoqërisë në favor të Pranuesit do të regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit në përputhje me Ligjin 9901/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe Ligjin 9723/2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

3.2. Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, ortake te Shoqërisë "ORPC-ALBANIA" Sh.P.K. me pjesëmarrje si vijon do te jene:

- Z. Fran Radaçi mbetet zotëruar i 34 % (tridhjetë e kater perqind) te kuotave;
- Z. Marian Radaçi bëhet zotëruar i 33 % (tridhjetë e kater perqind) te kuotave;
- Z. Bledar Mejdani mbetet zotëruar i 33% (tridhjetë e tre perqind) te kuotave;



3.3. Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Pranuesi gëzon të gjitha të drejtat për të regjistruar pronësinë mbi kuotat në emër të tij në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit si dhe pranë çdo institucioni tjetër shtetëror sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 4 Të ndryshme

4.1. Çdo kusht, klauzolë apo parashikim i kësaj Kontrate do të jetë i vlefshëm pavarësisht kushteve, klauzolare apo parashikimeve të tjera dhe vlefshmëria e një kushti, klauzole apo parashikimi nuk do të çenohej nga pavlefshmëria e një kushti, klauzole apo parashikimi tjetër.

4.2. Kjo Kontratë do të interpretohet dhe zbatohet në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe të çdo dispozite tjetër rregulluese sipas legjislacionit shqiptar të aplikueshëm.

4.3. Çdo konflikt që ka lindur si pasojë apo lidhet me këtë Kontratë do të zgjidhet në marrëveshje ndërmjet Palëve, në rast të kundërt kompetente për zgjidhjen e konflikteve është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

4.4. Kjo Kontratë hartohet në gjuhën shqipe në 4 (katër) kopje origjinale dhe me vlerë të njëjtë provuese.

Kjo Kontratë pasi iu lexua Palëve me zë të lartë e të qartë, nga unë Noteri, dhe pasi u gjet në përputhje me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u nënshkrua rregullisht prej Palëve në praninë time dhe unë, Noteri, e vërtetoj atë sipas ligjit dhe për gjithë efektet që passjell.

DHURUESI

Fran Radaçi

PRANUESI

Marian Radaçi

NOTERI

JULIAN ZHELEGU



VENDIM
I ASAMBLESE SE ORTAKAVE TE SHOQERISE
"ORPC - ALBANIA" Sh.p.k.

Sot, me date 10.06.2015, ortaku e shoqerise "ORPC - ALBANIA" Sh.P.K, shoqeri tregtare me pergjegjesi te kufizuar, e krijuar e qe funksionon ne perputhje me legjislacionin shqiptar, e regjistruar pranë Qendres Kombetare te Regjistrimit me Numer Unik Identifikimi NUIS L12227020K.

Sot më datë 10.06.2015, në selinë e shoqërisë janë prezente ortaket e shoqerise Fran Radaçi dhe Bledar Mejdani, te cilet perfaqesojne 100% (njqind per qind) te kapitalit themeltar te shoqerise.

Rendi i dites eshte:

- Miratimi i transferimit permes dhurimit te 33 % te kuotave te zoteruara nga Ortaku Fran Radaçi ne kapitalin e shoqerise "ORPC - ALBANIA" Sh.p.k.
- Te tjera eventuale;

Në bazë të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për shoqëritë tregtare", dhe në bazë të Statutit të Shoqërisë, asambleja e ortakeve, ne unanimitet:

VENDOSI:

- Te miratoje transferimin permes dhurimit te 33 % te kuotave te zoteruara nga ortaku Fran Radaçi ne favor te pranuesit te dhurimit Z. Marian Radaçi.
- Depozitim e ketij vendimi dhe te kontrates se dhurimit te kuotave te dt. 10.06.2015 pranë Qendres Kombetare te Regjistrimit (QKR), duke autorizuar per kete qellim Z. Glen Sakej.

ASAMBLEJA E ORTAKAVE
TE SHOQERISE "ORPC - ALBANIA" Sh.p.k.

